



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

Jetëshkrim

Znj. Freskida Halilaj mban detyrën e Administratores së Përgjithshme të IdentiTek prej tetorit 2024.

Ajo është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, ku ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Financë. Gjatë vitit 2024, ka ndjekur një Program Ekzekutiv në Leadership në Shkollën e Biznesit të Universitetit të Stanfordit, Kaliforni. Gjatë karrierës së saj, ka ndjekur një sërë kualifikimesh dhe trajnimesh në strategji, menaxhim produktesh, teknologji dhe inovacion.

Znj. Halilaj ka një përvojë të pasur profesionale, duke përfshirë një vit si Venture Capitalist në Plug and Play Tech Center, Silicon Valley.

Më herët, ka punuar në pozicione drejtuese për 10 vite në sektorin e telekomunikacionit.

Karriera e saj nisi menjëherë pas përfundimit të studimeve, duke ndjekur një rritje të vazhdueshme në detyrë si rezultat i strategjive të suksesshme, përmirësimit të proceseve dhe zhvillimit të produkteve teknologjike të avancuara.

Përvoja e znj. Halilaj përfshin pjesëmarrje aktive në konferenca dhe ngjarje ndërkombëtare në fushën e teknologjisë, inovacionit dhe investimeve në startup-e, si: Amazon Web Services Conference, Silicon Valley Summit (Dhjetor 2023) dhe Global Entrepreneurship Summit, Silicon Valley.

Misioni i znj. Halilaj është të mbështesë zhvillimin dixhital duke krijuar procese dhe sisteme të avancuara që lehtësojnë jetën e qytetarëve shqiptarë.

Kontakt: freskida.halilaj@identitek.com